



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 00.5.2023

Nr:

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE PËR
KRYETAR TË BASHKISË DHE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, NË ZONËN ZGJEDHORE BASHKIA
FIER, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 20.5.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar Bashkie dhe për Këshillin e Bashkisë, zona zgjedhore Bashkia Fier, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Neni 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, neni 123, neni 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore”, u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Kjo zonë zgjedhore ka 3 (tre) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr. 57, ZAZ nr.58 dhe ZAZ nr. 59.

Pas përfundimit të procesit të numërimit të votave, KZAZ-të përkatëse plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të zonave përkatëse për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Fier, si dhe për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Fier.

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për njësinë e qeverisjes vendore, territori i së cilës është i ndarë në dy apo më shumë ZAZ, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse.

Data: . .2023 Nr: 00
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Fier, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

KZAZ nr. 57, KZAZ nr.58 dhe KZAZ nr. 59 kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, tabelat përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Fier dhe për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Fier, vendimet përkatëse për miratimin e tabelave përmbledhëse të rezultateve, si dhe tabelat origjinale të rezultatit për çdo qendër votimi si për kryetarin dhe për këshillin, të ZAZ-ve të sipërcituara.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore si për Kryetarin dhe për Këshillin e bashkisë Fier, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të përkatësisht ZAZ nr. 57, ZAZ nr.58, ZAZ nr. 59, nëse tabelat e rezultateve të ZAZ-ve të zonës përkatëse përfshijnë të gjitha tabelat e qendrave të votimit të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-ve si për kryetarin ashtu edhe për këshillin, përfshijnë rezultatit e të gjitha tabelave të rezultateve të çdo QV-je të zonës përkatëse, përveç rezultatit të QV-së nr. 3133/00 në ZAZ-në nr. 58, që me vendim të KZAZ-së nr. 58, kutia me fletë votimi për kryetar është shpallur kuti e parregullt.

KQZ-ja do të miratojë me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Fier dhe Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Fier, Qarku Fier, në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ e zonës zgjedhore përkatëse duke ndjekur procedurat e parashikuara në nenin 123 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 123, nenin 166, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S :

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Fier, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpalljen fitues të z. Armando Subashi si Kryetar i Bashkisë Fier, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
3. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për zgjedhjen e Këshillit të Bashkisë Fier, sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: . .2023 Nr:
Ora:



“Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë dhe për Këshillin e Bashkisë, në zonën zgjedhore Bashkia Fier, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KRYETARIN E BASHKISË

BASHKIA FIER, QARKU FIER



Lidhja 1

		ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	44.882	43.572	79.276	167.730
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	13.863	13.744	25.543	53.150
3	Vota të pavlefshme	440	557	1.143	2.140
4	Vota të vlefshme	13.408	13.163	24.366	50.937
5	Fletë votimi të hedhura gabim	15	24	34	73
1	Evdar Ilirjan Kodheli	2.275	2.351	5.466	10.092
2	Eriselda Pëllumb Çelaj	1.491	1.524	2.521	5.536
3	Armando Nikolla Subashi	9.642	9.288	16.379	35.309
	Totali i votave të vlefshme	13.408	13.163	24.366	50.937



ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, 14 MAJ 2023

TABELË PËRMBLEDHËSE E REZULTATEVE PËR KËSHILLIN E BASHKISË

BASHKIA FIER, QARKU FIER



Lidhja 2

		ZAZ 57	ZAZ 58	ZAZ 59	TOTALI
1	Nr Zgjedhësve në listë	44882	43572	79276	167.730
2	Fletë votimi të gjetura në kuti	13856	13916	25540	53.312
3	Vota të pavlefshme	591	661	1038	2.290
4	Vota të vlefshme	13253	13233	24470	50.956
5	Fletë votimi të hedhura gabim	12	22	32	66
1	Bashkë Fitojmë	1374	1531	3746	6651
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	8285	8067	13371	29723
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	261	178	448	887
4	Partia Republikane Shqiptare	407	48	167	622
5	Partia Levizja e Legalitetit	54	52	166	272
6	Partia Demokracia Sociale	307	158	372	837
7	Aleanca Liberale e Djathtë	224	570	527	1321
8	Partia Socialdemokrate	920	1264	2486	4670
9	Partia Demokratike	1104	1055	1962	4121
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	77	60	96	233
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	240	250	1129	1619
	Totali i votave të vlefshme	13.253	13.233	24.470	50.956